



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:161444

Datë: 23.08.2024

Numri i dokumentit: 06081601

**P.nr.527/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm**,përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen penale kundër të pandehurit R.K...nga Gj..., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK),me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm për dhënien e urdhrin ndëshkimor me numër PP.II.nr.1126/2023 të datës 24.07.2023, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor, me datë 23.08.2024, mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan për dhënien e urdhrin ndëshkimor me numër PP.II.nr.1126/2023 të datës 24.07.2023, ndaj të pandehurit **R.K....**, nga babai N., i lindur me datë ..., me vendbanim në Gj., lagja „...”, me numër personal ..., shifra e konsumatorit D., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë 08.07.2023, në kohë të pa përcaktuar, në shtëpinë e tij në Gjilan, punëtorët e KEDS-it kanë konstatuar se i pandehuri, si konsumator i energjisë elektrike, ka siguruar shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, duke shmangë pagesën për shërbime të tilla, ashtu që, fillimisht njehsori elektrik i është shkyçur nga distanca për shkak të borxhit ndaj KEDS-sit, mirëpo, i pandehuri, pa leje dhe autorizim, ka bërë lidhjen e drejtpërdrejtë në rrjetin elektrik, pa orë matëse, me çka është pamundësuar regjistrimi i shpenzimeve të energjisë elektrike, në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS-in, Distrikti në Gjilan, i ka shkaktuar dëm material në shumë prej,176 euro e 58 cent.

-Me çka ka kryer veprën penale, vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-s.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38,39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së si dhe nenit 495 të KPP-së të pandehurin e lartcekur:

**E G J Y K O N**

I. Me dënim me gjobë në shumë prej 100 € (njëqind euro) të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

II. Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim.

III. E dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridik civil.

IV. Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) si dhe shumën prej 20 € (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 24.07.2023, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1126/2023 kundër të pandehurit R.K...nga Gj... për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)dhe njëherit gjykatës i ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe shqiptimin e dënimit me gjobë për të pandehurin me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPP-ës.

Gjykata pas shikimit dhe analizimit të aktakuzës përkatëse dhe shkresave të lëndës së bashku me kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se në këtë çështje penalo juridike janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-së, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe konform nenit 495 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPP-së vendosi që të pranojë kërkesën e lartcekur dhe të pandehurit ti shqiptoj dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkangjitura në të ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë dhe deri tek një konstatim i tillë gjykata erdhi duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës siç janë: procesverbali me numër 2148073 i datës 08.07.2023, ID e rastit 481851 i datës 10.07.2023, të lëshuar nga Departamenti për Konsumator – Sektori i Rikthimit të humbjeve, Distrikti në Gjilan, fatura DGLHP 2313542 e datës 10.07.2023, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe rrjedhimisht bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë ashtu siç është propozuar nga prokurori i shtetit në kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor mund të arrihen qëllimet e dënimit nga neni 38 i KPKR-s.

Duke pasur parasysh se në dispozitivin e aktakuzës lëndore është cekur vlera e dëmit mirëpo lidhur me llogaritjen e këtij dëmi nuk ka ndonjë ekspertizë të veçantë por e njëjta është bërë në bazë të kalkulimit të përgjithshëm të cilën e bënë vet e dëmtuara gjykata konsideron se këto të dhëna nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesshëm të kërkesës pasurore juridike andaj edhe bazuar në nenin 462 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës të dëmtuarën KEDS-Distrikti në Gjilan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në bazë të nenit 495 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPP-ës gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i përgjithshëm P.nr.527/2023, me datë 23.08.2024**

Bashkëpunëtoresh profesionale,  
Vlora Selmani-Rahimi

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Behar Ymeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri në këtë gjykatë mund të paraqet kundërshtim në afat prej 8 ditëve.